

Marrëveshje

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

dhe

Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë

për

Bashkëpunim Financiar

2016

për projektin

“Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
dhe
Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë –

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë datë 29 nëntor 2016 (nota verbale nr. 349/2016) -

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

(1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) për projektin "Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I" shumat e mëposhtme:

1. Një kredi të butë të KfW-së, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, në vlerë të përgjithshme deri në 30 000 000 euro (me fjalë: tridhjetë milionë euro), nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur, dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Ky projekt nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.

2. një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 euro (me fjalë: dy milionë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit.

(2) Shuma e financimit e përmendur në paragrafin 1, shifra 2, mund të përdoret për projekte të tjera, nëse për këtë bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

(3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau kredi ose suma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 apo për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

(1) Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosive përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huasë dhe shumës së financimit,

të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

(2) Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të huasë dhe financimit nuk lidhen brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Afati për shumat e përmendura mbaron më 31 dhjetor 2022.

(3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i kredisë, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të marrësve të huasë në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

(4) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar si dhe taksat e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Taksat e veçanta të konsumit, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahas kësaj Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën

Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5


(1) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

(2) Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo bisedimeve përkatëse.

(3) Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë, më _____ në dy originalë, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë



Për Qeverinë e
Republikës Federale të Gjermanisë

Abkommen

zwischen

dem Ministerrat der Republik Albanien

und

der Regierung der Bundesrepublik Deutschland

über

Finanzielle Zusammenarbeit

2016

für das Vorhaben

“Investitionsprogramm Stromverteilung I”

Der Ministerrat der Republik Albanien
und
die Regierung der Bundesrepublik Deutschland –

im Geiste der bestehenden freundschaftlichen Beziehungen zwischen der Republik Albanien und der Bundesrepublik Deutschland,

in dem Wunsch, diese freundschaftlichen Beziehungen durch partnerschaftliche Finanzielle Zusammenarbeit zu festigen und zu vertiefen,

in dem Bewusstsein, dass die Aufrechterhaltung dieser Beziehungen die Grundlage dieses Abkommens ist,

in der Absicht, zur sozialen und wirtschaftlichen Entwicklung in der Republik Albanien beizutragen,

unter Bezugnahme auf das Protokoll der Regierungsverhandlungen vom 12. Juli 2016 und die Zusage der Botschaft der Bundesrepublik Deutschland vom 29. November 2016 (Verbalnote Nr. 349/2016) –

sind wie folgt übereingekommen:

Artikel 1

(1) Die Regierung der Bundesrepublik Deutschland ermöglicht es dem Ministerrat der Republik Albanien oder anderen, von beiden Regierungen gemeinsam auszuwählenden Empfängern, von der Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) für das Vorhaben „Investitionsprogramm Stromverteilung I“ folgende Beträge zu erhalten:

1. ein vergünstigtes Darlehen der KfW, das im Rahmen der öffentlichen Entwicklungszusammenarbeit gewährt wird, in Höhe von bis zu 30 000 000 Euro (in Worten: dreißig Millionen Euro), wenn nach Prüfung die entwicklungspolitische Förderungswürdigkeit des Vorhabens festgestellt worden ist und die gute Kreditwürdigkeit der Republik Albanien weiterhin gegeben ist und der Ministerrat der Republik Albanien eine Staatsgarantie gewährt, sofern er nicht selbst Kreditnehmer wird. Das Vorhaben kann nicht durch andere Vorhaben ersetzt werden,
 2. einen Finanzierungsbeitrag für notwendige Begleitmaßnahmen zur Durchführung und Betreuung des Vorhabens von insgesamt 2 000 000 Euro (in Worten: zwei Millionen Euro).
- (2) Der in Absatz 1 Nummer 2 bezeichnete Finanzierungsbeitrag kann im Einvernehmen zwischen dem Ministerrat der Republik Albanien und der Regierung der Bundesrepublik Deutschland für andere Vorhaben verwendet werden.
- (3) Falls die Regierung der Bundesrepublik Deutschland es dem Ministerrat der Republik Albanien zu einem späteren Zeitpunkt ermöglicht, weitere Darlehen oder Finanzierungsbeiträge zur Vorbereitung des in Absatz 1 genannten Vorhabens oder weitere Finanzierungsbeiträge für notwendige Begleitmaßnahmen zur Durchführung und Betreuung des in Absatz 1 genannten Vorhabens von der KfW zu erhalten, findet dieses Abkommen Anwendung.

Artikel 2

(1) Die Verwendung der in Artikel 1 genannten Beträge, die Bedingungen, zu denen sie zur Verfügung gestellt werden, sowie das Verfahren der Auftragsvergabe bestimmen die zwischen der KfW und den Empfängern des Darlehens und des Finanzierungsbeitrags zu schließenden Verträge, die den in der Bundesrepublik Deutschland geltenden Rechtsvorschriften unterliegen.

(2) Die Zusage der in Artikel 1 genannten Beträge entfällt, soweit nicht innerhalb einer Frist von sechs Jahren nach dem Zusagejahr die entsprechenden Darlehens- und Finanzierungsverträge geschlossen wurden. Für diese Beträge endet die Frist mit Ablauf des 31. Dezember 2022.

(3) Der Ministerrat der Republik Albanien, soweit er nicht selbst Darlehensnehmer ist, wird gegenüber der KfW alle Zahlungen in Euro in Erfüllung von Verbindlichkeiten der Darlehensnehmer aufgrund der nach Absatz 1 zu schließenden Verträge garantieren.

(4) Der Ministerrat der Republik Albanien, soweit er nicht selbst Empfänger des Finanzierungsbeitrags ist, wird etwaige Rückzahlungsansprüche, die aufgrund der nach Absatz 1 zu schließenden Finanzierungsverträge entstehen können, gegenüber der KfW garantieren.

Artikel 3

Der Ministerrat der Republik Albanien befreit die KfW von direkten Steuern, die im Zusammenhang mit dem Abschluss und der Durchführung der in Artikel 2 Absatz 1 genannten Verträge in der Republik Albanien erhoben werden. In diesem Zusammenhang erhobene Umsatzsteuer und ähnliche indirekte Steuern werden vom Ministerrat der Republik Albanien getragen. Erhobene besondere Verbrauchsteuern werden vom Ministerrat der Republik Albanien übernommen. Darüber hinaus befreit der Ministerrat der Republik Albanien die KfW von sonstigen öffentlichen Abgaben.

Artikel 4

Der Ministerrat der Republik Albanien überlässt bei den sich aus der Gewährung des Finanzierungsbeitrags ergebenden Transporten von Personen und Gütern im See-, Land- und Luftverkehr den Passagieren und Lieferanten die freie Wahl der Verkehrsunternehmen, trifft keine Maßnahmen, welche die gleichberechtigte Beteiligung der Verkehrsunternehmen mit Sitz in der Bundesrepublik Deutschland ausschließen oder erschweren, und erteilt gegebenenfalls die für eine Beteiligung dieser Verkehrsunternehmen erforderlichen Genehmigungen.

Artikel 5


(1) Dieses Abkommen tritt an dem Tag in Kraft, an dem der Ministerrat der Republik Albanien der Regierung der Bundesrepublik Deutschland mitgeteilt hat, dass die innerstaatlichen Voraussetzungen für das Inkrafttreten erfüllt sind. Maßgebend ist der Tag des Eingangs der Mitteilung.

(2) Streitigkeiten über die Auslegung oder Anwendung dieses Abkommens werden durch die Vertragsparteien gütlich im Rahmen von Gesprächen beziehungsweise Verhandlungen beigelegt.

(3) Die Registrierung dieses Abkommens beim Sekretariat der Vereinten Nationen nach Artikel 102 der Charta der Vereinten Nationen wird unverzüglich nach seinem Inkrafttreten vom Ministerrat der Republik Albanien veranlasst. Die andere Vertragspartei wird unter Angabe der VN-Registrierungsnummer von der erfolgten Registrierung unterrichtet, sobald diese vom Sekretariat der Vereinten Nationen bestätigt worden ist.

Geschehen zu Tirana am in zwei Urschriften, jede in albanischer und deutscher Sprache, wobei jeder Wortlaut gleichermaßen verbindlich ist.

Für den Ministerrat der
Republik Albanien



Für die Regierung der
Bundesrepublik Deutschland